

## STATUTI I SHOQËRISË

"HIDRI CO & SKI" SH.P.K.

### KREU I

EMËRTIMI, SELIA, KOHËZGJATJA, AKTIVITETI, PARIMI I DETYRIMIT TE BESNIKËRISË

### NENI 1

#### EMËRTIMI I SHOQËRISË DHE ORTAKET E SHOQERISE

Shoqëria emërtohet "HIDRI CO & SKI" shpk. Ajo është person juridik dhe zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, me Statutin dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Dritan HIDRI, lindur më 09.03.1983, ne Tirane, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me Pasaporte shqiptare me Nr. BG3649496 dhe Nr.personal I30309019G.

Foti Hidri lindur me 22/03/1962 ne Dorez ,me zotësi te plote per te vepruar, i pajisur me Karte identiteti shqiptare me Nr.ID 035649802 dhe Nr.personal G20322014F.

Kosovare Mustafa e dl.31/12/1990, lindur ne Prishtine dhe banuese ne Trieste, Itali ne adrese: Rruga "Giuseppe di Vittorio", 2/04, Itali, me zotësi te plote per te vepruar, e pajisur me Karte identiteti Italiane me Nr.AY 5642961.

### NENI 2

#### SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë është në Durres me adresë:

Fshati Dorez, Lagjia "Balza", Zona Kadastrale 1517, Nr.Pasurise 283/7, Librazhd.

Shoqëria do të ketë edhe vënd qëndrime të tjera të dyta, filiale dhe përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe, me aprovimin e organeve kompetente edhe jashtë tij.

### NENI 3

#### KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është pa afat.

### NENI 4

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:

Shoqëria do te kryeje veprimtari ne fushen e Agroturizmit dhe zhvillimit rural. Investime per realizimin e projekteve ne fushen e turizmit, parqeve te skive dhe te argetimit, shfrytezimit dhe drejtimit te strukturave turistike.

Sherbim transporti me teleferik.

Zhvillimin e veprimtarive te ndryshme sportive, argetuese, lojra, etj.

Sherbim hotelerie.Bar-restorant.

Aktivitet ne fushen e blegtorise,mbareshtimin e kafsheve te ndryshme, dele, dhi, krijimin e baxhove per perpunimin e produkteve dhe nenprodukteve te qumeshtit, etj.

Aktivitet ne fushen e ndertimit duke perfshire ndertimet civile dhe industriale, social kulturore, turistike, qendra biznesi dhe banimi, hotele dhe komplekse hotelerie, pista skish, ura si dhe çdo lloj konstruksioni inxhinierik. Projektim, zbatim dhe mbikqyrje te punimeve te ndertimit. Zhvillimi i aktivitetit tregtar , tregtim te artikujve te ndryshem industrial e ushqimore, makineri e pajisje te ndryshme, pajisje per ski, artikuj te tjere qe kane lidhje me aktivitetin e shoqerise.

NENI 5  
E DREJTA

Shoqëria është person juridik i së drejtës shqiptare e themeluar me vendim të ortakëve që ushtron veprimtarinë e saj tregtare në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit shqiptar në fuqi si Ligjit 9901 date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjit n. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i modifikuar) e në përputhje dhe në zbatim të Aktit të Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë të përditësuar në përputhje me ligjet e lartpërmendura.

NENI 6  
PARIMI I DETYRIMIT TË BESNIKËRISË

Gjatë ushtrimit të të drejtave ortakët e shoqërisë veprojnë duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorin e shoqerise.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR, TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR, ANULLIMI I KUOTAVE, E DREJTA E PRONËSISË SË SHOQËRISË, ADRESA E ORTAKËVE, VULA E SHOQËRISË

NENI 7  
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njqindmije)leke dhe përfaqësohet nga 3(tre) kuota.

Z.Dritan Hidri është zoterues i 1 kuote me 75% pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise ne vleren 75.000 leke.

Z.Foti Hidri është zoterues i 1 kuote me 10% pjesemarrje ne kaptalin e shoqerise ne vleren 10.000 leke.

Znj.Kosovare Mustafa, është zotëruese e 1 kuote, me 15 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 15.000 leke.

Kapitali fillestar i shoqërisë do të mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 8  
TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR

Kuotat e kapitalit mund të shiten nga ortakët e shoqërisë me vleren nominale ose sipas nje vlere tjetër të pranuar midis shitësit dhe blerësit. Shitja e kuotave duhet të jetë në përputhje me kuotat e poseduara nga ortakët dhe ju bëhet e njohur me akt të shkruar dhe regjistruar në regjistrin e shoqërisë.

NENI 9  
TRANSFERIMI I KUOTAVE TË TRETËVË

Kuotat e kapitalit themeltar mund tu transferohen lirisht personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri nese ky vendim është i aprovuar nga ortakët që përfaqësojnë totalisht të paktën 51% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

NENI 10  
TRANSFERIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI

Kuotat e kapitalit, në rast vdekjeje i kalojnë trashëgimtarëve duke hyrë këta të fundit në shoqëri me të gjitha të drejtat e ortakut.

NENI 11  
ANULLIMI I KUOTAVE NGA SHOQËRIA

Mund të procedohet në anulimin e kuotave mbi të gjitha kur sjellja e ortakut është pengesë në kryerjen e aktivitetit dhe detyrave statutore të shoqërisë. Në këtë rast, ortakut i likujdohet megjithatë vlera e kuotës te tij dhe kuotat e tij u ndahen ortakëve të tjerë që bëjnë kërkesë në mënyrë gjithmonë proporcionale me kuotat e kapitalit që tashmë disponojnë.

NENI 12  
PËRGJEGJËSIA E SHOQËRISË

Shoqëria vepron në rregjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta dhe detyrime. Shoqëria përgjigjet me pasurinë e saj për detyrimet e saj kontraktore dhe jashtë kontraktore ndaj të tretëve. Ajo nuk përgjigjet për detyrimet e ortakëve në veçanti, por për humbjet e shoqërisë deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Ortakët nuk përgjigjen me pasurinë e tyre vetiake për detyrimet e shoqërisë që vijnë nga veprimtaria që kryejnë në emër dhe për llogari të shoqërisë me të tretët.

NENI 13  
ADRESA E ORTAKËVE

Adresa e ortakëve përsa i përket marrdhënieve të tyre me shoqërinë është ajo e regjistruar në librin e ortakëve themelues të shoqërisë e cila mund te përditësohet. Do te jeteë detyrim i ortakëve të komunikojnë me shkrim me anë të rekomandesë me lajmërim marrje që vërteton dorëzimin efektiv në nje vendbanim te ndryshem nga ai i deklaruar me parë. E njejta procedurë do të zbatohet për çdo përditësim të mëtejshëm.

NENI 14  
VULA E SHOQËRISË

Shoqëria ka vulën e saj me të njëjtin emërtim si vetë shoqëria. Përdorimi i vulës është i rezervuar ekskluzivisht administratorit, me përjashtim të nje ortaku tjetër që të jetë posaçërisht i deleguar.

KREU III  
ASAMBLEJA E ORTAKËVE, E DREJTA E VOTËS, PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË ORTAKËVE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË, DETYRIMI I BESNIKËRISË DHE PËRGJEGJËSIA

NENI 15  
ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë që përbëhet nga të gjithë ortakët.

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorit një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet për të cilat Asambleja duhet të marrë vendim.

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;

\* Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratori/ët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

\* Mbledhja e Asamblese është e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakët që zoterojnë më shumë se 30% të kuotave, për të vendosur për çështje të zakonshme. Në këtë rast, vendimi i Asamblese është i vlefshëm nëse është votuar nga shumica e ortakëve pjesëmarrës, (e cilesuar në këtë statut si " shumice e thjeshtë").

\* Mbledhja e Asamblese së Përgjithshme realizohet për të vendosur për çështje të veçanta si: Ndryshimi i Statutit, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, është e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakët që zoterojnë më shumë se 50% të kuotave. Në këtë rast vendimi i Asamblese është i vlefshëm nëse është votuar nga jo më pak se 3/4 (tre të katërtat) e votave të ortakëve pjesëmarrës (e cilesuar në këtë statut si " shumice e kualifikuar").

\* Mbledhja e Asamblese së Ortakëve drejtohet nga Administratori nëse është e thirrur prej tij. Nëse Mbledhja e Asamblese së Ortakëve është thirrur nga pakica, atëherë ajo kryesohet nga njeri prej ortakëve i zgjedhur nga pjesëmarrësit në atë mbledhje.

Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret të paktën 2 herë në vit.

\* Asambleja e Përgjithshme thirret në çdo rast që është e nevojshme mbrojtja e interesave të shoqërisë.

\* Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara, me përjashtim të rastit kur blerjet kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë në kushte normale tregu.

\* Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

\* Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur në këtë mënyrë, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### NENI 16 E DREJTA E VOTËS

Cdo kuotë jep të drejtën e një vote duke kuptuar me shprehjen "cdo kuotë" posedimin e të paktën të një vlere 1% të kapitalit të shoqërisë. Ortakët që nuk janë të pranishëm mund të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to: a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale; b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehën për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër; c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ky ligj apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: a) vlerësimin e veprimtarisë së tij; b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### NENI 17 PROÇESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme. Procesverbali duhet të përmbajë datën dhe vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

#### NENI 18 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrimi i shoqërisë realizohet nga administratori i saj **Z.Foti HIDRI**, ortak themelues i shoqërisë, i cili emërohet për një afat jo më të gjatë se 5 vjet dhe ushtron përfaqësimin e shoqërisë. Konkretisht, administratori ka të drejtë e detyrohet të: a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme; b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare; c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim; d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit; e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të këtij ligji, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të Zakonshme.

#### NENI 19

#### DETYRIMI I BESNIKËRISË DHE PËRGJEGJËSIA

Administratori, përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të këtij ligji, detyrohet: a) të kryejë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis; b) të ushtrojë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita; c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim; ç) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë; d) të garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji; dh) të ushtrojë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mos veprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryen veprimet e mëposhtme: a) u kthen ortakëve kontributet; b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë; c) u shpërndan aktivet shoqërisë; ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; d) jep kredi.

#### NENI 20

#### PRISHJA E SHOQËRISË

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset: a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; b) me vendim të asamblesë së përgjithshme; c) me hapjen e procedurave të falimentimit; ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"; d) me vendim të gjykatës; dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

#### NENI 21

#### LARGIMI I ORTAKËVE

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit.

Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas paragrafit të parë të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme. Ortaku ka të drejtë të ngrëjë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk njuh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrëjë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhet në datën e largimit. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria.

## NENI 22

### PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut: a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkaktonte dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë; b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkelte statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj; c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohej të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngrë ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhet në datën e vendimit të formës së prerë të gjykatës përjashtimin. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

## NENI 23

### LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

KREU IV  
ZBATIMI I LIGJIT

NENI 24  
ZBATIMI I LIGJIT

Përsa nuk është parashikuar në këtë Statut vlejné dispozitat e ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 25


Ky akt u redaktua në kater kopje dhe u nenshkrua me vullnetin e lire te Ortakeve themelues te shoqerise.

**ORTAKET THEMELUES TE SHOQËRISË**

**Dritan HIDRI**



**Kosovare MUSTAFA**



**Foti HIDRI**



Date 08.07.2020